

Kontrata për mësimin e profesionit

Keni pas sukses – ndërmarrja ju ka premtuar gojarisht vendin për mësimin e profesionit. Në një hap të ardhshëm, përgjegjësit në ndërmarrjen ku do të mësoni profesionin, e plotësojnë kontratën për mësimin e profesionit dhe ua dërgojnë juve. Kontratën tashmë të nënshkruar nga ndërmarrja duhet ta nënshkruani edhe ju. Atëherë kontrata është e vlefshme. Në kontratë janë të shënuara shumë të dhëna të përgjithshme si adresa e ndërmarrjes ku do të mësoni profesionin, të dhënat tuaja personale, emërtimi i profesionit, kohëzgjatja e mësimit të profesionit, kohëzgjatja e kohës provuese ose shkollë e degës së profesionit, të cilën do ta ndiqni ju.

Por ka edhe detaje, të cilat duhet t'i shikoni pak më me vëmendje:

Leja e punës

Për disa lejet të caktuara të qëndrimit (p.sh. F, L, N) për mësimin e profesionit kërkohet edhe leja e punës. Kjo leje e punës duhet të rregullohet para fillimit të shkollimit themelorë profesional.

Përfaqësimi ligjorë

3. Représentant légal (père et/ou mère ou autorité tutélaire)

Nom	Prénom
Rue	Sexe: <input type="checkbox"/> m <input type="checkbox"/> f
NPA, lieu	No tél.

Nom	Prénom
Rue	Sexe: <input type="checkbox"/> m <input type="checkbox"/> f
NPA, lieu	No tél.

Nëse keni mbushur 18 vjet dhe keni hy në moshën e të rriturve, atëherë nuk keni nevojë për përfaqësues ligjorë. Si njeri i rritur e nënshkruani kontratën për mësim të profesionit dhe me këtë edhe merrni përgjegjësinë për sipër.

Shpërblimi/Paga

7. Indemnisation

Salaires brut

1 ^{re} année formation	Fr.	mois	semaine	heure	3 ^e année formation	Fr.	mois	semaine	heure
2 ^e année formation	Fr.	mois	semaine	heure	4 ^e année formation	Fr.	mois	semaine	heure

Indemnités diverses

1^{er} salaire: oui non (déductions du salaire brut, cotisations aux assurances sociales exceptées, voir chiffres 11 et 12)

Këtu është e shënuar sa fitoni gjatë muajit në vitet e ndryshme të mësimit të profesionit, se a do të merrni shtesa, nëse në ndërmarrje ose në shkollën e degës së profesionit jepni kontribut të jashtëzakonshëm ose nëse në ndërmarrja ku mësoni profesionin parasheh pagesën e një roge të 13-të.

Nëse jeni më të vjetër se 18 vjet, atëherë prej rrogës së shënuar në kontratë zbriten kontributet gjegjëse për AHV/AVS (Sigurimi i pleqërisë, të mbeturve dhe trashëgimtarëve), IV/AI (Sigurimi për rast invaliditeti) dhe ALV/AC/AD (Sigurimi në rast të papunësisë).

Orari i punës

8. Horaire de travail Y compris la formation scolaire le temps de travail se monte à

Heures par semaine: Jours de travail par semaine:

Un jour ou un demi-jour d'école équivaut à un jour ou un demi-jour de travail.

Durée maximum de la journée de travail, travail de nuit et du dimanche, éventuel travail supplémentaire:
Les dispositions légales doivent être respectées, en particulier la loi sur le travail et les ordonnances s'y rapportant.

Dispositions particulières

Orari maksimal i punës në Zvicër është mesatarisht 42 deri 45 orë në javë. Në disa degë mund të devijohet prej këtij orari. Bisedoni me përgjegjësit në ndërmarrjen tuaj të ardhshme ku mësoni profesionin, cili është orari i punës në profesionin tuaj.

Pajisjet e nevojshme për profesion

10. Acquisitions nécessaires à l'exercice de la profession

La personne en formation a besoin des outils professionnels et vêtements de travail suivants:

Les frais d'acquisition sont pris en charge par entreprise formatrice personne en formation/ représentant légal

Le nettoyage des vêtements professionnels incombe à entreprise formatrice personne en formation/ représentant légal

Për shumë profesione duhen veshmbathje e veçantë e punës dhe vegla personale të punës. Në kontratën për mësimin e profesionit është e rregulluar, se a e merr ndërmarrja përsipër furnizimin me to dhe mirëmbajtjen e tyre.

Sigurimet

11. Assurances

Assurance accidents
La personne en formation est obligatoirement assurée contre les accidents (LAA).
Les primes de l'**assurance accidents professionnels** sont prises en charge par l'entreprise formatrice.

Les primes de l'**assurance accidents non professionnels** sont prises en charge à raison de % par l'entreprise formatrice % par la personne en formation/ par le représentant légal

Assurance perte de gain en cas de maladie convenue oui non Si oui: Les primes sont prises en charge à raison de % par l'entreprise formatrice % par la personne en formation/ par le représentant légal
(L'entreprise doit prendre en charge au moins 50% des primes.)

Të rinjtë zakonisht vetëm janë të siguruar nga prindërit e tyre kundër fatkeqësive, shpesh si pjesë përbërëse e sigurimit shëndetësorë. Gjatë mësimin të profesionit në ndërmarrje tash jeni të siguruar nga ndërmarrja kundër fatkeqësive gjatë punës. Ndërmarrje ku mësoni profesionin gjithashtu ju siguron edhe kundër fatkeqësive edhe gjatë kohës tuaj së lirë. Ky sigurim është i detyrueshëm dhe në shumicën dërmuese të rasteve u zbriten nga paga e nxënësit. Informoni Arkën tuaj të sigurimit shëndetësorë se tashmë jeni të siguruar nga ndërmarrja për raste të fatkeqësisë.

Miratimi

15. Approbation L'autorité cantonale approuve le présent contrat d'apprentissage.

Lieu, date, timbre

Kontrata juaj e mësimin të profesionit miratohet nga Zyra për Shkollim Profesional e kantonit tuaj. Personi i cili nënshkruan këtë miratim është përgjegjës për profesionin tuaj gjegjësisht për vendin tuaj të mësimin të profesionit. Në rast se keni probleme gjatë shkollimit themelorë profesional, të cilat nuk mund t'i zgjidhni në bashkëpunim me ndërmarrjen tuaj ku mësoni profesionin ose me shkollën e degës së profesionit, atëherë e kontaktoni atë person.